



UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 5 datë 26.4.2017

“Për mbylljen e dy programeve të studimit”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” neni 3 pika 2 gërma b), neni 7 pika 2 gërma dh), neni 35 pika 1, neni 37 pika 1, neni 38 pika 1 gërma dh), në mbledhjen e datës 26.04.2017, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të konfirmojë mbylljen e programit të studimit Bachelor për “Administrim biznesi” në Filialin në Kukës.
2. Të konfirmojë mbylljen e programit të studimit Bachelor për “Gjuhë Angleze” në Filialin në Kukës.
3. Transferimin e studentëve të cilët nuk kanë përfunduar brenda kohëzgjatjes normale studimet në këto programe, në Fakultetin e Ekonomisë për programin e studimit Bachelor në “Administrim biznesi” dhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”.
4. Përcjelljen e këtij vendimi tek Ministrja e Arsimit dhe Sportit për veprime të mëtejshme, sipas ligjit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI